



Republika e Kosovës


Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Për :	Xhafer Gashi , Kryetar i Komunës së Obiliqit Burim Gërguri , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit	
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić , Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj , Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini , U.d Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 15/04/2019
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së Aktit të Kuvendit të Komunës së Obiliqit	Nr.020-150513
Lloji i aktit	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 1-48 për shfuqizimin e Vendimit Nr. 1-203 për lirim nga pagesa e taksave administrative për pagesën e lejes ndërtimore për të gjithë përfituesit e skemës së ndihmës sociale dhe për donatorët
I miratuar më datë: 29.03.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.04.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za :	Xhafer Gashi , gradonačelnik Opštine Obilić Burim Gërguri , predsedavajući Skupštine opštine Obilić	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jednici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Adrijana Hodžić , ministarka MALS-a Rozafa Ukimeraj , generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Venera Çerkini , v.d rukovodilac Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština	Datum: 15/04/2019
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Obilić	Br. 020-150513
Vrsta akta	Odluka	

Poštovani gradonačleniče,
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 1-48 za ukidanje Odluke br. 1-203 za oslobađanje od isplate administrativnih taksi za dozvolu za izgradnju za sve dobitnike šeme socijalne pomoći i za donatore
Usvojena dana, 29.03.2019.godine
Poredložena za razmatranje u MALS-u dana, 04.04.2019. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Qëllia e kësaj akti:
Nr. 1-48 Data 03.04.2019
Dati

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/1-040. (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim të vendimit nga nga MAPL, nr.VI-020-1505/11, të dt.28.01.2019, në mbledhjen e mbajtur me dt.29.3.2019, mori këtë:

V E N D I M

HYRESHËLLAZNA-INCOMING
REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRI E ADMINISTRIMIT TË PUEHTIT LOKAL
Ministry of Local Government Administration
Data: 04.04.2019
Dati:
Ezra:
Nr. i Lendës: Udhëç: Shtet:

1. Shfuqizohet vendimi nr.1-203, i dt.31.12.2018, për lirim nga pagesa e taksave administrative për pagesën e lejes ndërtimore për të gjithë përfituesit e skemës së ndihmës sociale (të cilët paraqesin kartelën e ndihmës sociale të vlefshme) dhe për donatorë.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

- T'i dërgohet
- Kryetarit
 - Kryesuesit
 - Nënkryetarit
 - MAPL
 - DEFZH
 - Anëtarëve të KPF
 - Anëtarëve të Kuvendit
 - Arkivit

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Burim Gërguri
Burim Gërguri

REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

PROKLAMIM

№ 17/2018 Dëshmitë 30.12.2018

Dh

12.12.2018



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obiliq - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pikat d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/1-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës nr.V-1336, të dt.10.12.2018, me mbledhjen e mbajtur me dt.26.12.2018, mori këtë:


V E N D I M

1. Apropohet kërkesa nga DPUKP, për lirimin nga pagesa e taksave administrative për pagesën e lejes ndërtimore për të gjithë përfituesit e skemës së ndihmës sociale (të çfiri paraqesin kartelën e ndihmës sociale të vlefshme) dhe për donatorë.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

T'i dërgohet
-Kryetarit
-Kryesuesit
-Nënkryetarit
-DPUKP
-MAPL
-Anëtarëve të KK
-Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Burim Gërguri
Burim Gërguri





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministiarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, Datë: 25.01.2019
Nr.020-1505/19

Për: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit
Burim Gerguri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit

Lënda: Shkresë përcjellëse

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar, **Vendimin Nr. 203** për aprovimin e kërkesës nga DPUKP, për lirimin nga pagesa e taksave administrative për pagesën e lejes ndërtimore për të gjithë përfituesit e skemës sociale dhe për donator, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit dhe nënshkruara nga Kryesuesi i KK të Obiliqit, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Duke u bazuar në nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2016 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me datë 04.01.2019, ka përcjellë aktin e lartshënuar për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.


MAPL, kërkon nga Komuna që zyrtarisht të njoftohet lidhur me ndërmarrjen e veprimeve konkrete për rishqyrtimin e këtij akti.

Bashkëngjitur gjeni Raportin nga MMPH lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë.

Me respekt,

Rozafa Ukimeraj
Sekretarja Përgjithshme e MAPL-së

Kopje: Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Aktorit të MAPL-së



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
 Ministarstva Sredine i Prostorang Planirauja
 Ministry of Environment and Spatial Planning

Për:	Ivan Todosijević, Minister në MAPL
Ce:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL Njësia për Administrimin e dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e dokumenteve në Komitë Departamenti i Igjor dhe Menjorim të Komitave
Përmban:	Fatmir Matoshi, Ministër i MMPH-së Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
Nga:	Vlora Osaj, u.d.Drejtor i Departamentit Igj.or, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Lenda:	Kerkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë
Udhëzimet:	09.01.2019
Udhëzimi i aktit:	Vendim i Komitës së Obshqarë

Ministër,
 Sekretar

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Aktëve të Komitave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Pushtat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Igjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e parashitët me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr.203 për aprovimin e kërkesës nga DPLK.P. për lirin nga pagesa e taksave administrative për pagesën e lejes ndërtimore për të gjithë përfituesit e skemës sociale dhe për donatore , i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliçit i miratuar nga Kuvendi Komunal Malishevë.

I miratuar me datë: 31.12.2018

I punësuar për shqyrtim në MAPI, me datë: 04.01.2019

I dërguar për shqyrtim në MAMPIL, me datë: 04.01.2019

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Më pas paturshmëri të aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ngjashmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1	Vendimi Nr.203, i miratuar me datë 31.12.2018, nga Kuvendi Komunal Malishevë	
	Preambula (hyrja e vendimit)	1.Preambulës së vendimit i mungon baza ligjore, në bazë të të cilit mund të legjohet liri nga pagesa e taksës dhe tarifës.
2		

Rezuar në të cilat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i propozoi MAPI-se që të kërkojë nga Kuvendi i Komunës Kryetari i Komunës që të ndërmarri veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mpreket në dispozicion të MAPI dhe komunës për çfarëdo sqarimi të nevojshëm në lidhje me këtë vlerësim.